



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L -063

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E AUTOSTRADËS
KIJEVË – ZAHAQ**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E AUTOSTRADËS
KIJEVË – ZAHAQ**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen për hua midis Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar më 18 Dhjetor 2017, Hua kjo për ndërtimin e autostradës Kijevë- Zahaq.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij ligji ratifikohet Marrëveshja për Hua midis Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar më 18 Dhjetor 2017, për projektin e autostradës Kijevë- Zahaq.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në Shtojcën e këtij ligji janë të bashkëngjitura dokumentet si në vijim:

1.1. Marrëveshja për Hua midis Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar me datë 18 Dhjetor 2017, për Projektin e Autostradës Kijevë – Zahaq; dhe

1.2. Termet dhe Kushtet e përgjithshme të datës 1 Dhjetor 2012.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -063
30 mars 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI